

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	06.08.	2021	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
03	4201/11	36709	



# REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E DRENASIT

Drejtoria për Buxhet dhe Financa  
03Nr.2021/02  
Drenas, më 06.08.2021



**Për: Menaxheret e programeve-nënprogrameve buxhetore**

**Nga: Kushtrim Bajraktari, Zyrtar Kryesor Financiar**

**Lënda: QARKORE E BRENDSHME BUXHETORE KOMUNALE 2021/02, PËRGATITJA E RISHIKIMIT TË PRIORITETEVE PËR BUXHETIN E DREJTORATEVE-ZYRËVE KOMUNALE 2022-2024**



## 1. Qëllimi

Qëllimi i kësaj Qarkoreje buxhetore është të njoftojë drejtoratet/ zyrët komunale rreth informatave që kërkohen dhe orarit kohor për kompletimin e procesit të rishikimit të prioriteteve nga drejtoratet- zyrët komunale, për periudhën 2022-2024.

## 2.Sfondi

Më procesin e ri buxhetor, kërkohet që buxheti komunal të zhvillohet sipas Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale ( KAB.Komunal). Qasja e KAB-it kërkon që komuna të shqyrtojë më përseafërmi nevojat dhe të bëjë caktimin e prioriteteve për alokimet buxhetore, për të siguruar pajtueshmërinë me objektivat e saj ekonomike, fiskale e sociale. **Rishikimi i prioriteteve nga drejtoratet-zyrët komunale, do t'u ofrojë mundësinë mbajtsve të buxheteve-menaxherëve të programeve që të identifikojnë propozimet për shpenzime të prioritetit të lartë, bashkë me kursimet potenciale në programet e prioritet të ulët, apo më performancë të dobët, para se të bëhet përcaktimi i kufijëve final të buxhetit për secilin drejtorat-program buxhetor.** Gjatë periudhës maj – qershor 2021, komuna ka përgatitur Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale në të cilën theksohen prioritetet për buxhetin komunal 2022-2024. Këto prioritete janë:

- zhvillimin ekonomik;
- planifikimin urban dhe rural;
- shfrytëzimin e tokës;
- zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- mbrojtjen e mjedisit lokal;
- formimin dhe mirëmbajtjen e shërbimve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin më ujë, mirëmbajtjen e kanalizimeve, trajtimin e ujrave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transporti lokal;
- përgjegje ndaj rasteve emergjente lokale;

- h) ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- i) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- j) ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor;
- k) ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirqenjës sociale, siq është përkujdesi për strehim familjar raste emergjente, përkujdesin fëmijnore, përkujdesin për të moshuarit;
- l) banimin publik;
- m) shëndetësin publike;
- n) licencimin e shërbimeve publike dhe objektive, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me arzetimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transporti lokal publik dhe taksit;
- o) emertimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- p) aktivitete kulturore dhe të lira.

**Drejtoratet-zyrët komunale duhet t'i shfrytëzojnë këto prioritete të larta si udhërrefyës në përgatitjen e rishikimit të prioriteteve të tyre, për të cilat kërkohen para. Minimizimi i shpenzimeve rrjedhëse, karrshi atyra kapitale duhet të ketë prioritet**

### **3.Shqyrtimi i prioriteteve të drejtorateve-zyrëve komunale**

Nga të gjitha drejtoratet-zyrët, kërkohet të bëjnë rishikimin e programeve-projektev të tyre dhe prioriteteve të shfaqura në kontekst të prioriteteve buxhetore të komunës (shih më lartë).

Ky rishikim i prioriteteve do t'u ofrojë mundësinë vendim-marrësve ( Kryetarit të Komunës, Komuniteti për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës) që të bëjnë shqyrtimin e propozimeve të shkurtra nga drejtoratet në një fazë të hershme dhe të identifikojnë ato propozime për të cilat do të kërkohet vlerësim më i hollësishëm në dorëzimet e plota buxhetore. Si të tilla, vetëm informata të shkurtra dhe arsyetime (**PROJEKTE KONKRETE**) kërkohen gjatë rishikimit të prioriteteve.

Formati për kompletimin e rishikimit është dhënë në **Shtojcën 1** më sa vijon:

**Tabela 1:** kërkon një deklaratë mbi strategjinë e drejtoratit-zyrës, me fokus në rezultatet që planifikohet të arrihen gjatë periudhës afatmesme.

**Tabela 2:** ofron listën e opsioneve për kursime. Opsioni për kursime mund të jetë (a) propozimi për reduktimin e shpenzimeve në një projekt të caktuar, për shkak të efikasitetit që propozohet apo reduktimeve në nivelin e shërbimeve apo (b) anulimi i propozuar i një projekti që nuk është më i nevojshëm, ka performancë të dobët, përkatësisht është më prioritet të ulët.

**Tabela 3:** ofron listën e propozimeve për politikat e reja prioritare të mundshme, për t'u marrë parasysh për financim me buxhet . Politika e re përfshin zgjerimin e projekteve ekzistuese apo vazhdimin e projekteve që janë para përfundimit, si dhe programet apo projektet tërësisht të reja. Është më rëndësi që kjo përfshin gjithashtu cilendo kërkesë për ri-ndarjen e resurseve për projektet kapitale. Vlerësimet fillestare (vetëm indikative) të kostos duhet të përfshihen poashtu. **Kompletimi i projekteve kapitale tanimë të filluara dhe/apo zotuar dhe atyre të ri-planifikuara nga viti paraprak, duhet të ketë prioritetin më të lartë për financimin e politikës së re.**

Nuk është e domosdoshme që programet apo kursimet e reja të filluara, të fillojnë në vitin 2021, pasi që ky është një planë për periudhën 2022-2024, kursimi i propozuar apo projekti i ri mund të fillojë edhe më vonë.

Qëllimi i listës është të ndihmojë dhe të inkurajojë caktimin e prioriteteve (dhe ri-caktimin e tyre) për resurset buxhetore në programet që kanë si synim plotësimin e objektivave më të rëndësishme fiskale e sociale të komunës.

#### **4. Veprimi që kërkohet**

Të gjitha drejtoratet-zyrët komunale duhet të veprojnë në këtë menyrë, më qëllim të kompletimit të rishikimit të prioriteteve :

1. Rishikimi i vlerësimeve të hershme të programeve-projekteve ekzistuese, që janë përgatitur dhe përfshirë në dokumentin e KAB -it,
2. Kompletimi i Tabeles 1 duke specifikuar prioritetet për periudhën 2022-2024,
3. **Emërtimi i grupit punues intern për rishikimin e të gjitha programeve dhe projekteve ekzistuese dhe të reja, në raport më prioritetet e komunës (udhëhequr nga DZHE-ja).** Identifikimi i kursimeve dhe propozimeve për politikat e reja për secilin drejtorat-zyrë komunale që janë ndryshime të propozuara në vlerësimet e hershme, dukepërfshirë:
  - a. Programet apo projektet që duhet të anulohen apo reduktohen gjatë periudhës 2022-2024 (Tabela 2).
  - b. Projektet apo programet e reja që janë në pajtim me prioritetet e komunës (Tabela 3).
  - c. Vazhdimi i projektit apo programit që është financuar në buxhetin e vitit 2021, për të cilin nuk ka fonde në vlerësimet e hershme (Tabela 3).
  - d. Financimi i nevojshëm për shkak të mos përfundimit të projekteve kapitale që fillimisht janë planifikuar të kompletohen në vitin 2021- duke reflektur faktin që të gjitha ndarjet buxhetore të vitit 2021 skadojnë më 31 dhjetor 2021 dhe nuk do të ketë bartje të fondeve, apo fonde të pashpenzuara, më përjashtim të të hyrave

vetanake të komunës, Tabela 3, Zgjerimi apo zhvillimi i mëtejshëm i programit apo projektit ekzistues .

- e. Financimi nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK) në të ardhmen i ndonjë programi apo projekti që aktualisht financohet nga donatorët, përfshirë këtu kërkesën për financim nga BKK të shpenzimeve periodike që lidhen me projektet kapitale të financuara nga donatorët (Tabela 3).
4. Kompletimi i Tabelave 1, 2, 3, **së bashku me formën e kërkesës për buxhet të pranuar në fazën e parë** të përgatiten duk u bazuar në kërkesat- sygjerimet e paraqitura në këtë Qarkore. **Aplikimi i kostos për njësi, si dhe stoku dhe rrjedha gjatë përgatitjes së kërkesave finale buxhetore është i obligueshme, për të arsyetuar faturën e shpenzimit të projektit-programit konkret.**
5. Sigurimi i aprovimit për të gjitha propozimet dhe tabelat të bëhet nga Kryetari i Komunës -Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA).
6. Respektimi i Qarkorës Buxhetore 2022/01 dhe 2022/02 për komuna- MFPT-ja, si dhe Qarkoreve të mbrendshme buxhetore 2021/01 dhe 2021/02 është i obligueshëm.
7. Kompletimi dhe kthimi i të gjitha tabelave **së bashku me formularin e kërkesës finale** të përgatitur dhe shpërndarë nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa **në fazën e parë** të planifikimit të dërgohën në Sektorin për Buxhet dhe Financa-DBF-në, më së largu më **12.8.2021**. Për vonesën e të dhënave ne nukmbajmi përgjegjësi.
8. Pas skadimit të afatit kohor të përcaktuar më lartë (**12.8.2021**) ZKF-DBF-ja, duhet (i) të shqyrtojë propozim-buxhetet dhe kërkesat për ndarje buxhetore nga **13-18 Gusht 2021** të cilat janë dorëzuar nga mbajtësit e buxheteve komunale, dhe (ii) të mbajë takime me secilin mbajtës të buxhetit, më qëllim të shqyrtimit dhe kuptimit të propozim-buxhetit dhe të departamenteve përkatëse si dhe për të bërë përpjekje për zgjedhjen e çështjeve dhe shqetësimeve që kanë të bëjnë me propozim-buxhetin, veçanarisht sa ka të bëjë me përputhshmërinë e propozim-buxhetit me tavanet e brendshme Komunale të shpenzimeve dhe qarkorën buxhetore komunale. Takimi i Bordit të Drejtorve të mbahet më **19.08.2021**.
9. Pas mbajtjes së takimeve të parapara më lartë , ZKF-ja kërkohet të përgatis dhe t'i dorëzojë Kryetarit të Komunës buxhetin e propozuar Komunal për vitin e ardhshëm fiskal (2022) dhe vlerësimet për 2 (dy) vitet e ardhshme fiskale. Këto dokumente duhet të dorëzohen në formën e cila është në pajtim me qarkoren buxhetore të nxjerrë nga Ministri i Financave, Pronës dhe Transfereve. ZKF-ja duhet që njëkohësisht t'u shpërndajë programeve-nënprogrameve komunale propozim-buxhetin për vitin e ardhshëm fiskal.

10. Pas miratimit të propozim-Buxhetit Komunal nga Kryetari i Komunës, Kryetari i Komunës, **deri me 1 Shtator 2021**, duhet t'ia dorëzojë këto dokumente Kuvendit Komunal, duke kaluar përmes Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF-së), **d.t 27.08.2021**. Të dhënat financiare si faturat, shpenzimet dhe financimi, si dhe dokumentacioni tjetër i paraqitur në propozim-Buxhetin Komunal duhet të jetë gjithë përfshirës, transparent dhe në përputhje me Sistemin e Klasifikimit në Bazën e Parave të Gatshme të SFQ (Statistikat Financiare Qeveritare) i cili publikohet kohë pas kohe nga FMN-ja. Propozim-Buxheti Komunal duhet të përfshijë:

- a) parashikime dhe supozime ekonomike dhe buxhetore;
- b) vlerësime të përgjithshme të të ardhurave nga të gjitha burimet, duke përfshirë (i) grantet, në përputhje me shumat e këshilluara në qarkoren buxhetore të nxjerra nga Ministri i Financave, (ii) ndihmën nga burimet jashtë Kosovës, dhe (iii) të ardhurat e parashikuara vetanake të komunës;
- c) një cak të përgjithshëm të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimit;
- d) vlerësime të përkrahjes së pritur nga donatorët; dhe
- e) çfarëdo të dhëna të tjera me rëndësi materjale për buxhetin të cilat konsiderohen të arsyeshme për t'u përfshirë.

11. Duke vepruar sipas Ligjit për Barazi Gjinore Nr.05/L-020 (2015) institucionet e Kosovës janë përgjegjëse për „përfshirjen e buxhetit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve “ (Neni 5.1.5). Për këtë arsye, programet buxhetore duhet ti bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë gjinore në buxhetin vjetor për vitin 2022. Kjo do të kontribuon gjithashtu në rritjen e efektivitetit dhe transparencës së menaxhimit të parasë publike.

12. Pasi Principi i Transparencës në planifikim të buxhetit është i domosdoshëm, kërkohet që të mbahen degjime buxhetore më qytetar. Koha për organizimin e mbajtjes së degjimeve buxhetore në emer të ekzekutivit do të ishte më së miri të jetë nga **data: 20 deri më 25.GUSHT.2021** .

Qarkorja e brendshme buxhetore është përgatitur duke u bazuar në LMFP-it, përkatësisht neni 60.1, si dhe në Qarkoret Buxhetore të lëshuara nga Ministri i Financave. **Qarkorja e brendshme buxhetore kërkohet t'i dërgohet mbajtësit të buxhetit për secilin program-nënprogram buxhetor**, për të pasur informata dhe udhëzime të vlefshme lidhur me procedurat e planifikimit të buxhetit komunal.

**SHTOJCA 1 – FORMULARËT PËR RISHIKIMIN E PRIORITETEVE NGA DREJTORATET**  
(Tabela 1, 2 dhe 3)

**Tabela1. Strategjia e Drejtoratit :**

**Drejtorati [...ju lutemi tregoni drejtoratin përkatës-tuaj]**

Përmbledhje e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen (misioni/synimet):

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale)

Vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve gjatë periudhës buxhetore:

Plani i propozuar për adresimin e mundësive dhe kërcënimeve (aktivitetet e propozuara për të ardhmen):

**Tabela 2. Propozimet e drejtorateve për kursime (kursimet indikative)**

<b>Emri i programit</b>			
Shpjegimi i kursimeve:			
Kursimi potencial (Euro)	<b>2022</b> Vlerësimi buxhetor	<b>2023</b> Vlerësimi i hershëm	<b>2024</b> Vlerësimi i hershëm
Paga dhe Mëditja			
Mallra dhe Shërbime dhe Sh.Sh.Komunale			
Subvencione- Transfere			
Shpenzime Kapitale			
<b>Raporti përmbledhes</b>			

**Tabela 3. Propozimet e drejtorateve për shpenzime të reja (kosoja indikative)**

<b>Emri i programit</b>			
Radhitja e propozimit (sipas prioritetit)			
Arsyetimi (njedhimet që duhet të arrihen më politikën e re):			
Shpenzimet shtesë (Euro)	<b>2022</b> Vlerësimi buxhetor	<b>2023</b> Vlerësimi i hershëm	<b>2024</b> Vlerësimi i hershëm
Paga dhe Mëditje			
Mallra dhe Shërbime dhe Sh.Sh.Komunale			
Subvencione – Transfere			
Shpenzime Kapitale			
<b>Raporti përmbledhës</b>			